



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 10
Data 26. 06. 2008

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Shkumbin Demalija, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Melihate Termkolli, Gani Geci,
Zafir Berisha, dhe Eqrem Kryeziu.

Munguan: Agim Veliu, Bojan Stojanovič, Zylfi Merxha

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhja filloi në orën 10:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, me këtë rend dite:

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 12 qershor 2008
3. Vlerësimi i vizitës në Shqipëri dhe miratimi i raportit nga vizita
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për Sigurinë Private
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Kontrollin e Armëve të Vogla
6. Të ndryshme

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë: Procesverbali i mbledhjes së datës 12.06.2008, u miratua pa vërejtje.

Pika e tretë: Në lidhje me këtë pikë, kryesuesi delegacionit z. Zafir Berisha tha, në këtë raport janë përfshi në përgjithësi të gjitha çështjet e rëndësishme të vizitës, prandaj unë mund të them se ne jemi shumë të kënaqur me mbështetjen që na është dhënë, si nga ana e Kryeparlamentares z. Josefina Topalli, ashtu edhe nga Ministrat dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë të segmenteve të sigurisë, në Republikën e Shqipërisë.

Melihate Termkolli, në lidhje me këtë pikë pati një vërejtje, që në fund të raportit të mos shkruhet emri i Kryetarit të Komisionit, por emri i kryesuesit të delegacionit, dhe pasi të miratohet raporti në komision, atëherë të dërgohet për Kryesinë e Kuvendit me nënshkrim të Kryetarit të Komisionit.

Naim Maloku tha, pa dashur të bëjë replikë për znj. Termkolli, por në raport qenkan përfshi emrat e personave që kanë marr pjesë në këtë vizitë, si dhe është cekur se kush është kryesues i delegacionit. Në legjislaturën e kaluar, ne kemi filluar që ti raportojmë Kryesisë së Kuvendit dhe nëse Kryesia e vlerëson si të nevojshme, atëherë e qetë në rend dite në seancë plenare për deputet. Ndërsa sa i përket çështjeve procedurale duhet të shikohet më shumë se si duhet të vepohet.

Eqrem Kryeziu tha, ky raport po tregon se delegacioni është pritur mjaft në nivel të lart dhe mendoj se Kuvendit të Shqipërisë, duhet tu kthehet një shkresë falënderuese.

Raporti nga vizita në Shqipëri u miratua pa vërejtje.

Pika e katërt: Në lidhje me këtë pikë z. Emrush Xhemajli, si kryesues i Projektligjit për Sigurinë Private, tha se, na ka ardhur një ndërhyrje nga MPB-ja, në amendamentin e 31, që pas fjalës “pas miratimit të këtij ligji” të futet fjala “ deri në skadimin e licencës, ndërsa” edhe pse në amendament po kuptohet por ata kanë kërkuar ta precizojnë, prandaj ju mund ta japin pëlqimin tuaj për këtë inkorporim të fjalisë.

Naim Maloku, tha se është më mirë të precizohet deri në skadimin e licencës, në mënyrë që të dihet se pas skadimit të licencës kompanitë do të hyn në të njëjtat procedura si të gjitha ndërmarrjet tjera që fillojnë për herë të parë veprimtarin e tyre.

Shkumbin Demaliaj, e kundërshtoi futjen e kësaj fjalie, sepse licenca ka një afat të caktuar, prandaj mendoj se nuk duhet fare të inkorporohet.

Amendamenti 31, u miratua me inkorporimin e fjalës së propozuar nga MPB-ja, por shtohet edhe fjala afatin e skadimit të licencës.

Pika e pestë: Në këtë pikë kryetari i komisionit parashtroj disa çështje. Çështja e parë kishte të bënte me projektligjin për armët, si referues i këtij projektligji caktohet z.Shkumbin Demaliaj.

Shkumbin Demaliaj tha, se do të përkushtohem shumë për amendamentimin e këtij projektligji, pra do të organizojmë një dëgjim publik, ku do ti ftojme të gjithë personat përgjegjës.

Çështja e dytë kishte të bënte me Ligjin për Shpërbërjen e TMK-së. Ne e dimë se ky proces është specifik dhe ligji parasheh, që komisioni ynë mund të kërkojë nga Qeveria dhe Prania Ndërkombëtare Ushtarake në Kosovës informacione rreth këtij procesi. Prandaj unë jam i mendimit që të kontaktojmë me Zyrën e Koordinatorit të TMK-së, të kërkojmë një vizitë atje apo ti thërrasim në komision.

Naim Maloku tha, procesi i shpërbërjes së TMK-së, do të bëhet nën mbikëqyrjen e Komisionit Për Punë të Brendshme dhe Siguri. Prandaj ne duhet ta japim kontributin tonë maksimal në këtë proces si dhe në projektligjin për Pensionimin e Parakohshëm të pjesëtarëve të TMK-së.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

Kryetari i Komisionit
Rrustem Mustafa